VENDIM
Nr. 639, datë 6.11.2017

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(ndryshuar me VKM nr. 665, datë 19.10.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, të jetë gjithsej *23 veta*.
4. Vendimi nr. 930, datë 28.12.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Skema 1

STRUKTURA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN



SKE M A 2

ORGANIKA E AGJENCISE SE AUDITIMIT TE PROGRANIEVE TE ASISTENCES, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN
(ndryshuar numri i audituesit të parë në ndarjen IV me VKM nr. 665, datë 19.10.2022)

POZICIONI	**KATEGORIA**	**NUMRI**
I. DREJTOR I PERGJITHSHEM	II-a	1
II. ZEVENDESDREJTOR I PERGJITHSHEM	11-b	1
III. DREJTORIA E AUDITIMIT TE PROGRAMEVE IPA		(7)
DREJTOR	II-b	1
AUDITUES I PARE	II-b	3
AUDITUES I DYTE	III-a	3
IV . DREJTORIA E AUDITIMIT TE PROGRAMIT IPARD		*(7)*
DRE JTOR	II-b	1
AUDITUES I PARE	II-b	*4*
AUDITUES I DYTE	III -a	2

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
V. DREJTORIA E FINANCES DHE JURIDIKE		(7)
DREJTOR	Il-b	1
SEKTORI I FINANCES DHE ADMINISTRATES		(3)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST (BUXHET, FINANCE)	IV-a	1
SPECIALIST (BURIME NJEREZOR.EIARKIV PROTOKOLL)	IV-a	1
SEKTORI JURIDIK DHE MARREDHENIEVE ME JASHI E		(3)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a/!	1
SPECIALIST (JURIST)	IV-a	1
SPECIALIST (MARRE DHE NIE ME JASHTE)	IV-a	1
PUNONJES GJITHSEJ		**21**

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA